

Anketa e Buxhetit të Familjes

Janar – Dhjetor 2015

Tiranë, më 17 Nëntor 2016: Gjatë periudhës Janar 2015 - Dhjetor 2015, u krye Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) realizuar nga INSTAT pranë 7.335 Njësive Ekonomike Familjare (NjEF), e cila bën të mundur përshkrimin e shpenzimeve për konsum të NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Në periudhën e referencës, shpenzimet mesatare mujore për konsum¹ të NjEF vlerësohen të jenë 70.766 lekë, duke pasur parasysh se një NjEF në Shqipëri përbëhet mesatarisht nga 4 persona. Sipas anketës vlerësohet se totali i shpenzimeve për konsum të NjEF për vitin 2015 është rreth 54 miliardë lekë në muaj dhe numri i NjEF në Shqipëri është 764.115. Nëse konsiderojmë shpenzimet për frymë në periudhën një-vjeçare të kryerjes së anketës, rezulton se një individ në Shqipëri shpenzon rreth 18.600 lekë në muaj për konsum nga të cilat: 9.100 për konsum ushqimor dhe 9.500 lekë për konsum jo-ushqimor.

Tab.1 Shpenzimet për konsum të NjEF dhe struktura e tyre, 2015


Grupet kryesore të konsumit	Vlera (në lekë)	Në %
Ushqime dhe pije jo-alkoolike	34.489	48,7
Pije alkoolike, duhan	2.507	3,5
Veshje dhe këpucë	3.449	4,9
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar	7.318	10,3
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës	3.378	4,8
Shëndet	2.533	3,6
Transport	4.796	6,8
Komunikim	2.095	3,0
Argëtim dhe kulturë	2.082	2,9
Arsim	1.505	2,1
Restorante dhe hotele	2.537	3,6
Të tjera mallra dhe shërbime	4.076	5,8
Shpenzime gjithsej	70.766	100,0

¹ Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF janë shpenzimet që kryen mesatarisht një NjEF për t'a dalluar nga NjEF gjithsej në Shqipëri, të cilat sillen me bazë mujore pasi mblidhen nga anketa përgjatë gjithë vitit. Në vijim do t'i referohemi shkurtimisht "shpenzimeve mesatare mujore për konsum" me termin "shpenzime për konsum".

Struktura e shpenzimeve për konsum të NjEF është paraqitur sipas ndarjes në 12 grupet kryesore² (Tabela 1). Grupi “Ushqime dhe pije jo-alkoolike” mbetet elementi më i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 48,7 përqind të tij. Tre nëngrupet që në vitin 2015, ashtu si dhe në vitet e kaluara, zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë: “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” (18,8 përqind të buxhetit brenda grupit), “mish dhe nënprodukte” (17,4 përqind të buxhetit brenda grupit) dhe “bukë dhe drithëra” (17,0 përqind të buxhetit brenda grupit). Nëngrupet që vijnë më pas janë “perimet”, që zënë 13,3 përqind të grupit dhe “frutat” që zënë 7,9 përqind të tij.

Përsa i përket grupit “Pije alkoolike dhe duhan”, rezulton se shpenzimet për të përbëjnë rreth 3,5 përqind të buxhetit, ku “duhani” zë një peshë prej 63,2 përqind brenda grupit. Grupi “Restorante dhe hotele” përbën 3,6 përqind të buxhetit të NjEF. Brenda grupit, përqindjet e shpenzimeve për restorante përbëjnë pjesën më të madhe, 87,5 përqind ndërsa shpenzimet për hotele, 12,5 përqind.

Fig.1 Struktura e shpenzimeve për konsum, 2015



² Për më shumë detaje lidhur me përbajtjen e grupeve kryesore të konsumit, shih Ankes.3 në seksionin “Metodologji dhe Përkufizime”.

Shpenzimet për grupin “Veshje dhe këpucë”, zënë 4,9 përqind të buxhetit gjithsej, ku nëngrupi veshjet zë një peshë prej rreth 67,8 përqind dhe nëngrupi “këpucë dhe të ngjashme” zë 32,2 përqind. Grupi i shpenzimeve për banesën, i përfaqësuar nga shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla zë 10,3 përqind të totalit të buxhetit familjar. Rreth 49,4 përqind e këtyre shpenzimeve shkojnë për pagesën e energjisë elektrike dhe 24,1 përqind për lëndë të tjera si gaz, naftë, dru zjarri etj. Shpenzimet që shkojnë për nëngrupin “qira e paguar”, kanë një peshë prej 10,1 përqind ndërkohë që përqindja e NjEF që deklarohen se paguajnë qira për banesën e tyre është 5,5 përqind. Brenda grupit “Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtja e tyre”, i cili zë rreth 4,8 përqind në strukturën e shpenzimeve mesatare mujore, peshën më të madhe e zënë artikujt shtëpiake jo-afatgjatë, rreth 72,8 përqind.

Buxheti që NjEF i dedikojnë grupit “Shëndet”, i cili përfshin shpenzimet për kujdes shëndetësor, zë një peshë prej 3,6 përqind. Peshën më të madhe e zë blerja e medikamenteve, 77,9 përqind. Ndër shpenzimet për arsim, të cilat zënë 2,1 përqind të buxhetit, peshën më të madhe e zënë pagesat në lidhje me studimet pasuniversitare, 49,7 përqind. Në grupin “Komunikim”, me një peshë prej 3,0 përqind, pothuajse të gjitha shpenzimet e kryera nga NjEF i përkasin nëngrupit “shërbime telefonike”, duke zënë 98,1 përqind brenda grupit ndërsa pjesën tjetër e zë nëngrupi “shërbime postare” me 1,9 përqind.


Shpenzimet e përfshira në grupin “Transport” zënë në vitin 2015, 6,8 përqind të buxhetit. Peshën më të madhe brenda këtij grupi e përbëjnë “shpenzimet për karburantë dhe lubrifikantë”, 58,9 përqind, ndjekur nga “shërbim transporti” 18,9 përqind, ku përfshihet transporti rrugor, ajror, detar dhe lumor, ndër të cilat pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për transport rrugor, 81,7 përqind të nëngrupit.

Shpenzimet që NjEF i dedikojnë grupit “Të tjera mallra dhe shërbime” zënë një peshë prej 5,8 përqind të buxhetit gjithsej. Peshën më të madhe në këtë grup e zë nëngrupi “artikuj dhe produkte për kujdes personal” me 50,5 përqind. Shpenzimet e tjera në këtë grup shkojnë për nëngrupet “shpenzime të jashtëzakonshme” të kryera nga NjEF në raste ceremonish dhe festash, “pagesa për shërbime të ndryshme financiare private” dhe “sigurime”.

Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve

Anketa e Buxhetit të Familjes mundëson analizën e të dhënave statistikore në 12 qarqe. Qarku i Tiranës paraqet shpenzimet më të larta për konsum krahasuar me të gjitha qarqet e tjera: një NjEF në qarkun e Tiranës shpenzon për konsum mesatarisht 81.710 lekë në muaj. Qarqet që paraqesin shpenzimet më të larta për konsum pas qarkut të Tiranës janë: Qarku i Lezhës me shpenzime për konsum 79.374 lekë dhe qarku i Gjirokastrës me shpenzime për konsum 74.993 lekë në muaj për NjEF. Qarqet me nivel më të ulët të shpenzimeve për konsum janë qarku i Elbasanit me 55.671 lekë dhe qarku i Vlorës me 51.198 lekë për NjEF.

Fig.2 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2015



Tab.2 Madhësia mesatare e NjEF sipas qarqeve, 2015

Qarqe	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Shqipëri
Madhësia mesatare e NjEF	3,7	5,0	3,7	4,1	3,7	3,5	3,6	5,3	4,2	4,0	3,5	3,3	3,8

Shpërndarja e shpenzimeve për konsum sipas decileve dhe raporti 10/90

Një analizë e shpërndarjes së nivelit të shpenzimeve për konsum sipas decileve³ tregon se 90 përqind e NjEF shpenzojnë 80,4 përqind të vlerës së konsumit të të gjitha NjEF, me një mesatare të shpenzimeve për konsum prej 63.221 Lekë në muaj, ndërsa 10 përqindëshi tjetër shpenzon 19,6 përqind të konsumit gjithsej me një shpenzim mesatar prej 138.711 Lekë për NjEF. Sipas treguesit të raportit të decileve 10/90, shpenzimet mesatare për konsum të 10 përqindëshit të NjEF me shpenzime më të larta, janë 2,2 herë mbi ato të 90 përqindëshit tjetër.

Analiza e të njëjtit fenomen nga këndvështrimi i shpenzimeve të konsumit për frymë, rezulton se popullsia që korrespondon me 90 përqind të NjEF shpenzon mesatarisht 17.687 Lekë në muaj për frymë, ndërsa pjesa tjetër që korrespondon me 10 përqind të NjEF me shpenzime më të larta shpenzon mesatarisht 58.582 në muaj për frymë ose 3,3 herë më shumë.

Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit sipas tipit të NjEF

Niveli dhe struktura e shpenzimeve për konsum ndryshojnë në varësi të madhësisë dhe përbërjes së NjEF. Kështu, NjEF të përbëra nga një person i vetëm me fëmijë në varësi shpenzojnë më shumë për ushqim, krahasuar me tipet e tjera. Shpenzimet për veshje dhe këpucë janë më të larta në NjEF me fëmijë në varësi. Shpenzimet më të larta në transport paraqiten në NjEF e përbëra nga dy të rritur apo më shumë me fëmijë, dhe tre ose më shumë të rritur pa fëmijë. Shpenzimet më të larta për arsim regjistrohen në NjEF e përbëra nga një person i vetëm me fëmijë në varësi.

³ Raporti i decileve shpreh nivelin e pabarazisë së shpenzimeve për konsum si raport i shpenzimeve të 10 përqindëshit të popullsisë që shpenzon më shumë për konsum ndaj shpenzimeve për konsum të pjesës tjetër prej 90 përqind të popullsisë.

Tab.3 Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit sipas tipit të NjEF në përqindje, 2015

Grupet kryesore të konsumit	Tipi i Njesisë Ekonomike Familjare						Gjithsej
	Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tre ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tre ose më shumë të rritur me fëmijë	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	52,6	54,0	50,6	48,6	47,5	48,3	48,7
Pije alkoolike, duhan	3,1	2,7	3,5	2,9	3,8	3,9	3,5
Veshje dhe këpucë	3,5	5,4	4,0	5,3	4,9	5,2	4,9
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar	13,1	9,1	11,4	10,8	10,4	9,3	10,3
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës	4,5	5,4	5,0	5,0	4,6	4,8	4,8
Shëndet	4,0	1,9	5,3	3,2	3,1	3,4	3,6
Transport	3,2	1,8	5,0	7,2	7,4	7,4	6,8
Komunikim	3,0	3,1	3,2	2,9	2,7	2,7	3,0
Argëtim dhe kulturë	1,6	4,2	2,8	3,6	2,8	2,8	2,9
Arsim	1,5	4,1	0,2	1,5	2,8	2,8	2,1
Restorante dhe hotele	5,5	3,4	4,1	2,8	3,4	3,4	3,6
Të tjera mallra dhe shërbime	4,4	4,8	4,9	6,2	6,0	6,0	5,8
Shpenzimet gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0

Shpenzimet mesatare për konsum të NjEF në periudhën 2014 - 2015

Vlerësimi i shpenzimeve për konsum të NjEF në vitin 2015 ishte 1,9 përqind më i lartë se në vitin 2014. Rritja e çmimeve të konsumit regjistruar për periudhën Janar - Dhjetor 2015 krahasuar me periudhën Janar - Dhjetor 2014 ishte 1,9 përqind.

Tab.4 Struktura e shpenzimeve të konsumit të NjEF në vitet 2014 dhe 2015

Grupet kryesore të konsumit	ABF 2014		ABF 2015	
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	30.745	44,3	34.489	48,7
Pije alkoolike dhe duhan	2.467	3,6	2.507	3,5
Veshje dhe këpucë	3.546	5,1	3.449	4,9
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7.085	10,2	7.318	10,3
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	3.772	5,4	3.378	4,8
Shëndet	3.337	4,8	2.533	3,6
Transport	4.713	6,8	4.796	6,8
Komunikim	2.299	3,3	2.095	3,0
Argëtim dhe kulturë	2.184	3,1	2.082	2,9
Arsim	2.901	4,2	1.505	2,1
Restorante dhe hotele	2.208	3,2	2.537	3,6
Të tjera mallra dhe shërbime	4.185	6,0	4.076	5,8
Shpenzimet gjithsej	69.442	100,0	70.766	100,0

Ndryshimi më i madh është regjistruar në grupin “Shpenzime ushqimore dhe pije jo-alkoolike”, i cili ka një rritje prej 4,4 përqind në krahasim me një vit më parë. Një rritje të lehtë ka pësuar gjithashtu grupi “Restorante dhe hotele” me 0,4 përqind dhe grupi “Shpenzime për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira të paguar” me 0,1 përqind.


Grupet që kanë regjistruar uljet më të mëdha në strukturën e shpenzimeve për konsum gjatë kësaj periudhe janë “Arsimi” me 2,1 përqind dhe “Shëndeti” me 1,2 përqind. Grupet e tjera me ulje të shpenzimeve për konsum janë “Mobilim, pajisje shtëpiake, mirëmbajtje e zakonshme e banesës” me 0,6 përqind dhe “Komunikim” me 0,3 përqind. Një ulje të lehtë kanë regjistruar edhe grupet “Veshje dhe këpucë”, “Argëtim dhe Kulturë”, “Të tjera mallra dhe shërbime” me 0,2 përqind secili si dhe grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,1 përqind. Grupi “Transport” zë të njëjtën përqindje brenda buxhetit të NjEF si në vitin e kaluar.

Ndryshimi i strukturës së grupeve kryesore të shpenzimeve në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014, është më së shumti pasojë e efektit të çmimeve i cili ka ndikuar në rritjen dhe rishpërndarjen e buxhetit të familjeve.

Shpërndarja e shpenzimeve për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2014 - 2015

Shpenzimet mesatare për konsum sipas qarqeve (Figura 3) kanë ndryshuar gjatë periudhës 2014 – 2015 duke shprehur në përgjithësi tendenca të ndryshme në renditjen e tyre për nga madhësia e shpenzimeve. Ashtu si në vitin 2014, qarku i Tiranës paraqitet me shpenzimet më të larta për konsum, pothuajse në të njëjtin nivel gjatë të dy viteve. Qarku i Lezhës vazhdon gjithashtu të jetë i dyti në renditje për nga madhësia e shpenzimeve, me një rritje të lehtë prej 0,7 përqind. Në vitin 2015 është qarku i Gjirokastrës që renditet në vendin e tretë me një rritje të lehtë prej 0,9 përqind ndërsa qarku i Shkodrës që renditej i treti në vitin 2014, ka regjistruar një rënie të shpenzimeve për konsum prej 2,4 përqind, duke kaluar në vendin e katërt. Një rritje e konsiderueshme paraqitet në qarkun e Durrësit (9,6 përqind), i cili kalon për nga renditja dhe mesataren e vendit, duke u bashkuar me katër qarqet me mirëqënien më të lartë në terma të shpenzimeve për konsum. Rritja më e lartë e shpenzimeve për konsum është regjistruar në qarkun e Kukësit dhe Korçës, përkatësisht 15,7 dhe 11,8 përqind. Ndërsa ulja më e theksuar e shpenzimeve të konsumit është regjistruar në qarkun e Dibrës, me 16,0 përqind.

Fig.3. Shpenzimet mesatare për NjEF sipas qarqeve , 2014 - 2015



Shpërndarja e shpenzimeve për konsum sipas decileve, 2014 - 2015

Shpenzimet për konsum të NjEF sipas decileve tregojnë se në vitin 2015, në krahasim me vitin 2014, ka pasur ulje të shpenzimeve të 10 përqindëshit me shpenzime më të larta dhe rritje të shpenzimeve përsa i përket 90 përqindëshit tjetër të tyre. (Tabela 5). Si rrjedhim raporti i decileve për këta tregues paraqet një ulje të pabarazisë përgjatë dy viteve.

Tab. 5 Shpenzimet mesatare mujore për konsum për NjEF dhe Raporti i decileve 10/90, 2014 - 2015

	2014		2015	
	Shpenzimet mesatare për konsum për NjEF	Madhësia mesatare e NjEF	Shpenzimet mesatare për konsum për NjEF	Madhësia mesatare e NjEF
10 % e NjEF (me shpenzimet më të larta)	149.510	2,6	138.711	2,4
90 % e NjEF të tjera	60.548	3,9	63.221	3,9
Konsumi mesatar	69.442	3,8	70.766	3,8
Raporti 10/90	2,5		2,2	

Nëse i referohemi shpenzimeve të konsumit për frymë, vëmë re se ruhet e njëjta tendencë përsa i përket uljes së tyre për popullsinë që korrespondon me 10 përqind të NJEF me shpenzime më të larta dhe rritjes së shpenzimeve të pjesës tjetër që korrespondon me 90 përqind të NjEF. Edhe raporti i decileve 10/90, tregon për një ulje të pabarazisë nga 3,6 në vitin 2014, në 3,3 në vitin 2015. (Tabela 6).

Tab. 6 Shpenzimet mesatare mujore për konsum për frymë dhe Raporti i decileve 10/90, 2014 - 2015

	2014		2015	
	Shpenzimet mesatare për konsum për frymë	Madhësia mesatare e NjEF	Shpenzimet mesatare për konsum për frymë	Madhësia mesatare e NjEF
10 % e NjEF (me shpenzimet më të larta)	61.047	2,6	58.582	2,4
90 % e NjEF të tjera	16.746	3,9	17.687	3,9
Konsumi mesatar	21.176	3,8	21.775	3,8
Raporti 10/90	3,6		3,3	

Metodologjia

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisve ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve.

Anketa e Buxhetit të Familjes u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009⁴ dhe që nga viti 2014 e vazhdueshme. Nga viti 2006-2007 anketa është kryer në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe me përfaqësim në nivel qarku.

Anketa e Buxhetit të Familjes 2015 u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 9.024 NjEF. Në përfundim të vrojtimit ishin intervistuar rreth 7.335 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 81,3 për qind.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censurit të homogjenizuara⁵, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censurit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 12 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Totali i NjEF të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të përfshirë edhe ndryshimet stinore. Si rrjedhim, janë anketuar çdo muaj rreth 752 NjEF të shpërndara njëtrajtësisht në të gjitha zonat e zgjedhura, për të siguruar përfaqësimin e çdo zone në të gjithë muajt e vitit.

Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:

- Plotësimi i një ditari nga ana e NjEF për 14 ditë në vazhdim ku regjistrohen shpenzimet për blerje produktesh/shërbimesh të konsumit të gjerë si dhe, sa herë që plotësohen kushtet, plotësimi i një ditari të veçantë për autokonsum ku familja regjistron vetëm produktet e prodhuara dhe të konsumuara gjatë 14 ditëve te referencës, vlerësuar me çmimin që do të kishte paguar për t'i blerë në dyqanin më të afërt.
- Kryerja e një interviste direkte nga anketuesit nëpërmjet një pyetësi ku përfshihen pyetje mbi shpenzimet me vlerë më të madhe dhe me frekuencë blerjeje më të rrallë, të grupuara dhe të ndara sipas temave të veçanta. Në të njëjtin pyetësor janë përfshirë edhe pyetjet mbi të dhënat socio-demografike të anëtarëve të NjEF që do të shërbejnë gjatë analizës së buxhetit familjar sipas tipologjive të NjEF.

⁴ Periudha e kryerjes në terren ishte: tetor 2006 - shtator 2007 dhe nëntor 2008 - tetor 2009.

⁵ Homogjene nënkupton që çdo zonë Censusi ka të njëjtat karakteristika në shpenzimet e konsumit midis NjEF dhe madhësia për secilën PSU ka përafërsisht të njëjtin numër NjEFapo individësh.

Çdo anketë e zhvilluar nga INSTAT bazohet në zgjedhjen e një kampioni për të nxjerrë përfundime për popullsinë në studim. Natyrshëm, ky proces shoqërohet me devijime statistikore. Për këtë arsye u llogaritën devijimet standarde të zgjedhjes të cilat përdoren për interpretimin e rezultateve të anketës.

Për Anketën e Buxhetit të Familjes 2015, janë llogaritur devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes. Në tabelat A1 dhe A2 jepen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit të shpenzimeve mesatare mujore për konsum sipas 12 grupeve kryesore të konsumit si dhe shpenzimet mesatare për konsum mujor sipas qarqeve.

Në përgjithësi, sa më e vogël të jetë vlera e devijimit standard relativ të një vlerësimi, aq më i lartë është niveli i saktësisë së vlerësimit. Për shembull, nëse vlerësimi i marrë për grupin “Ushqim dhe pije jo-alkoolike” është 34.489 Lekë , atëherë devijimi standard për këtë vlerësim është 253 Lekë. Nëse kombinojmë vlerësimin e marrë nga anketa për shpenzimet e kryera për këtë grup me devijimin standard përkatës mund të pohojmë me një siguri të nivelit 95 përqind se vlerësimi i shpenzimit për grupin “Ushqim dhe pije jo-alkoolike” është nga 33.992 Lekë në 34.986 Lekë.

Tabela A1. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për 12 grupet kryesore të shpenzimeve për konsum

	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi standard	Intervali i besimit 95%		Koeficienti i Variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet gjithsej	70.766	646	69.499	72.033	0,9
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	34.489	253	33.992	34.986	0,7
Pije alkoolike, duhan	2.507	76	2.357	2.657	3,0
Veshje dhe këpucë	3.449	89	3.275	3.623	2,6
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar	7.318	105	7.112	7.525	1,4
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës	3.378	47	3.286	3.469	1,4
Shëndet	2.533	73	2.390	2.676	2,9
Transport	4.796	146	4.510	5.081	3,0
Komunikim	2.095	30	2.037	2.153	1,4
Argëtim dhe kulturë	2.082	76	1.934	2.231	3,6
Arsim	1.505	163	1.186	1.825	10,8
Restorante dhe hotele	2.537	118	2.679	2.769	4,7
Të tjera mallra dhe shërbime	4.076	68	4.209	4.209	1,7

Tabela A2. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për shpenzimet për konsum sipas qarqeve.

	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi standard	Intervali i besimit 95%		Koefficienti i Variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet gjithsej	70.766	646	69.499	72.033	0,9
Berat	65.840	3.323	59.326	72.354	5,0
Dibër	56.221	2.708	50.913	61.530	4,8
Durrës	74.602	2.757	69.197	80.007	3,7
Elbasan	55.671	1.461	52.808	58.535	2,6
Fier	69.125	1.446	66.290	71.959	2,1
Gjirokastrë	74.993	2.326	70.433	79.553	3,1
Korçë	64.417	1.627	61.228	67.605	2,5
Kukës	68.989	4.189	60.776	77.202	6,1
Lezhë	79.374	3.403	72.703	86.046	4,3
Shkodër	74.658	2.169	70.405	78.910	2,9
Tiranë	81.710	1.403	78.960	84.461	1,7
Vlorë	51.198	1.724	47.818	54.577	3,4

Përkufizime:

Shpenzimet për konsum të NjEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012.

Periudha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Kryefamiljari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.

Fëmijë është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.

Aneksi 3 - Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)

Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	
KATEGORITË	Disa detaje përsa i perket zërave në cdo kategori të cilat shërbejnë vetëm për konsum familjar.
1 - USHQIME DHE PIJE JO-ALKOOLIKE	Produktet ushqimore të klasifikuara këtu janë ato të blera dhe të prodhuara për konsum në shtëpi.
	Grurë, Misër, Oriz, Miell dhe nënprodukte të tij, Bukë, Mish, Peshk, Produkte të tjera deti, Vaj, Fruta, Perime, Qumësht, Djathë, Gjalp, Gjizë, Vezë, ujë mineral dhe me gaz, lengje frutash, Kafe, Caj, Mjalt, Produkte Sheqeri, Te gjitha produktet e kesaj kategorie te prodhuara nga vete familja etj.
2 - PIJE ALKOOLIKE DHE DUHAN	Pijet alkoolike të klasifikuara këtu janë ato që zakonisht blihen për konsum në shtëpi.
	Verë, Birrë, Raki, Whisky, Të gjitha llojet e Likemave, Uzo dhe pije të tjera gjallëruese Duhan, Cigare, Puro, Letër cigare, Filtër etj.
3 - VESHJE DHE KËPUÇË	Në këtë zë përfshihen veshje, këpucë, të reja apo të përdorura, materiale për veshje, dhe riparimi i tyre, etj.
	Veshje për burra, gra, fëmijë (3 deri 13 vjeç) dhe foshnja (0 deri 2 vjeç), qofshin të gatshme ose të bëra me porosi, në të gjitha materialet (përfshirë lëkure, gëzof, plastike dhe gome), të përditëshme, për sporte ose për punë: pardesy, mantele shiu, bluza, xhupa, xhaketa, pantallona, kostume, fustane, funde, etj. Këmisha, bluza, pulovra, bluza pas trupit, pantallona të shkurtra, rroba banje, tuta, kostume vrapimi, geta ,etj. Jelek, të brendëshme, çorape, streçe, geta, sutiena, funde me palë, të brendëshme me tantellë, fustane nate, breza, korse, çorape të thurura, etj. Bizhama , bluza nate, robdishane, kostume banje, xhaketa për shtëpi, etj. Veshje për fëmijë dhe çorape të thurura për fëmijë
4 - STREHIMI, UJI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE LËNDE TË TJERA DJEGËSË	Në këtë zë përfshihen: Qiraja e paguar (si shpenzim i kryer efektivisht për marrjen e ambienteve të banimit me qira nga ana e NjEF), mirëmbajtja dhe riparimi i banesës, materiale për riparim, pagesa për energji elektrike: ujë, gaz, heqje plerash, dhe të gjitha pagesat që kanë lidhje me banesën e familjes etj.
5 - MOBILJE, PAJISJE PËR SHTËPINË DHE MIRËMBAJTJA E ZAKONSHME E SHTËPISË	Në këtë zë përfshihen: Krevate, sofa, divane, tavolina, karrige, bufë, komo dhe rafte librash, pajisjet e ndriçimit si abazhurë tavanesh, llampa standart, në formë globesh, dhe abazhurë komodinash , të gjitha llojet e tekstileve për shtëpi, pajisje elektroshtëpiake, pajisje dhe vegla për kopshtin, tapete, riparimi i tyre, pagesa për kopshtar, guzhiniere, dado etj.
6 - SHËNDETI	Ky grup mbulon ilaçet, protezat, makineritë dhe pajisjet mjekësore si dhe produkte të tjera të lidhura me mjekimin të blera nga individët, me dhe pa recetë, zakonisht nga furnizuesit e ilaçeve, aparatura dhe pajisje terapeutike, te gjitha llojet e shërbimeve mjekësore përfshirë dhe ato ambulatorë etj.
7 - TRANSPORTI	Të gjitha llojet e makinave, të reja dhe të përdorura, taxi, Bileta avionësh, të gjitha llojet e biletave Naftë, Gas, Pjesë këmbimi dhe riparime, Garazhde, etj.
8 - KOMUNIKIMI	Shërbime postare, të gjitha llojet e shërbimeve për komunikim, telefona, celularë, fax, internet etj.
9 - ARGËTIMI DHE KULTURA	Në këtë zë përfshihen të gjitha llojet e pajisjeve audio-vizuale, Aparate marrje, regjistrimi dhe riprodhimi të tingujve dhe filmave, Pajisjet e përpunimit të informacionit, Pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumente optike, Të mira afatgjata për argëtim në ambientet e jashtme, Pajisjet kryesore për lojra dhe sport, Bileta, lojra fati , riparimi dhe mirëmbajtja e tyre etj.
10 - ARSIMI	Kjo ndarje përfshin vetëm shërbimin e arsimit.
	Klasifikimi i shërbimeve të arsimit bazohet në kategoritë sipas niveleve të Klasifikimit Standart Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).
	Përfshihen: Arsimi parashkollor dhe fillor, Arsimi 8/9 vjeçar dhe i mesëm, Arsimi parauniversitar, Arsimi i lartë, Arsim i papërcaktuar në nivele (Kurse arsimit)
11 - RESTORANTE DHE HOTELE	Në këtë zë përfshihen: Restorante, bare dhe të tjera si këto, Shërbimet e akomodimit, menca, etj. Përfshihen: shërbime të shpërndarjes së produkteve ushqimore (ushqime, meze, pije dhe pije freskuese) të ofruara nga restorantet, kafenetë, bufetë, baret, etj. Hotele, motele, hane dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Qendra pushimesh, vende për kamping, bujtina për të rinjtë dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Shërbimet e akomodimit të institucioneve të tjera
12 – TË MIRA DHE SHËRBIME TË NDRYSHME	Në këtë zë përfshihen: Sallone bukurie dhe institucione të kujdesit personal, Pajisje elektrike dhe jo-elektrike për kujdes personal, riparimi i pajisjeve për kujdes personal, Sende personale, Përkrahja sociale, Sigurimi, Shërbime financiare të specifikuar, Shërbime të tjera të paspecifikuara etj.